



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 13/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-37051-09-24-2019 me objekt “*Supervizim në objektin “Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)*”, me fond limit 4.333.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.10.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Argi” shpk & “HMK-Consulting” shpk nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: “GB Civil Engineering” shpk
Rruga e Kavajës, ish parku pranë tregut 100 vitrinat,
Tiranë

BOE “Argi” shpk& “HMK-Consulting” shpk
Rruga “Rreshit Collaku” shpk nd.38, hyrja nr.6, ap.24
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Patos
Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 24.09.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-37051-09-24-2019 me objekt “*Supervizim në objektin “Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)*”, me fond limit 4.333.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.10.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datën 14.10.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 30.10.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Zenit&Co	3,500,000	I skualifikuar
- Instituti i Konsulencës në Ndërtim	3,641,555.36	I skualifikuar
- Argi	3,672,023	I skualifikuar
- Gjeokonsult&Co	3,739,612	I skualifikuar
- A&E Engineering	3,757,259	I skualifikuar
- HE&SK 11	3,792,508.07	I skualifikuar
- Novatech Studio	4,089,032	I skualifikuar
- G B Civil Engineering	4,140,228.33	I skualifikuar

II.4. Në datën 30.10.2019 operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Ju s’kualifikoheni pasi nuk plotësoni kriterin e vecantë të kualifikimit, kontratë shërbimi e ngjashme, pasi ne dy prej kontratave të mbikqyrjes të lidhura mungojnë formularët e vlerësimit.*

II.5. Në datën 31.10.2019 operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në kriteret e vecanta në lidhje me kapacitetin teknik nga ana e AK është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme shërbimesh në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit dhe konkretisht **1,733,333(nje milion e***

shtateqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave.

Për këtë pikë kemi hedhur në sistem gjashtë punë të ngjashme:

1. Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.2499 prot dt 12.09.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrje objekti për ndërtim linje ujësjellësi Ø 500 për lidhjen e depos së re Arapaj me rrjetin shpërndarës Plazh, Bashkia Durrës. Vlera e kontratës është 594,104 lekë pa tvsh. Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve*
- Kopje të faturës së shërbimit*
- Formular Vlerësimi nr.1961 prot datë 20.09.2018*
- Akt Kolaudimi*
- Situacion Përfundimtar*
- Akt Marrje në Dorëzim*

2. Kontratë për mbikqyrje punimesh me nr.1500/1 prot datë 06.05.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrje e objektit Ndërtim rrjeti i ri në lagjen Gramshi, Njësia Adm, Rashbull, Bashkia Durrës. Vlera e Kontratës është 296,230 lekë pa tvsh. Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve*
- Kopje të faturës së shërbimit*
- Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017*
- Akt Kolaudimi*
- Situacion përfundimtar*
- Akt Marrje në dorëzim të objektit*

3. Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1948/1 prot datë 17.07.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha, me objekt Mbikqyrje për prokurimin me objekt Përmirësimi i furnizimit me ujë lagjia 14, Bashkia Durrës. Vlera e Kontratës është 111,864 lekë pa tvsh. Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve*
- Kopje të faturës së shërbimit*
- Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017*
- Akt Kolaudimi*
- Situacion përfundimtar*

- Akt Marrje në dorëzim të objektit

4. Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1660/1 prot datë 22.06.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha , me objekt Mbikqyrje e objektit Rehabilitim i linjave kryesore të ujësjellësit lagjia 16, rruga H.Kertusha dhe A. Celkupa Bashkia Durrës. Vlera e kontratës është 231,385 lekë pa tvsh. Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve
- Kopje të faturës së shërbimit
- Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017
- Akt Kolaudimi
- Situacion përfundimtar
- Akt Marrje në dorëzim të objektit

Ju bëjmë me dije se për objektet 2,3,4 janë paraqitur në të njëjtin vërtetim realizimi nga ana e AK UKD sha.

5. Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1465 prot datë 26.06.2018 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrja e punimeve për zbatimin e objektit Rehabilitimi i linjave të ujësjellësit në lagjen 15, ish punishtja e makaronave, rruga Dardania, Gjeneral Telin, vëllezrit Frashëri, Pjetër Budi, Bashkia Durrës . Vlera e kontratës është 293,257 lekë pa tvsh. Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve
- Kopje të faturës së shërbimit
- Formular Vlerësimi Nr.2809/1 datë 05.10.2018
- Akt Kolaudimi
- Situacion Përfundimtar
- Akt Marrje në Dorëzim të objektit

6. Kontratë për mbikqyrje punimesh me nr.2328 prot datë 19.11.2018 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha, me objekt Mbikqyrje për prokurimin me objekt Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat e lagjeve nr.1, nr.4, nr.5, nr.8, nr.18 Bashkia Durrës. Vlera e kontratës është 436,338.62 lekë pa tvsh.

Për këtë objekt kemi insertuar në sistem:

- Kontratën mes palëve
- Kopje të faturës së shërbimit
- Formular Vlerësimi
- Akt Kolaudimi

- *Situacion Përfundimtar*
- *Akt Marrje në Dorëzim të objektit*

Të gjitha dokumentat e dorëzuara në seksionin e OE GB Civil Engineering janë të plota. Vlera totale e punëve të paraqitura është 1,963,178.62 lekë pa tvsh cka do të thotë që e plotësojmë më së miri këtë kriter me të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK Bashkia Patos. Kërkojmë nga ana e AK Bashkia Patos të bëjë rivlerësim për subjektin GB Civil Engineering dhe të na kualifikojë për më tej.

II.6. Me shkresën nr.2946/5 prot datë 06.11.2019 operatori ekonomik ankimues “GB Civil Engineering” shpk ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 14.11.2019 pala ankimuese “GB Civil Engineering” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 30.10.2019 BOE “Argi” shpk & “HMK-Consulting” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsye si më poshtë vijon.

Ju s'kualifikoheni pasi nuk plotësoni kriteret e mëposhtme:

- 1. Mbeshtetur në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe rekomandimin e APP Nr. 5585 Prot, datë 25. 07. 2017 mbi percaktimin e tarifave minimale, oferta ekonomike e paraqitur prej jush rezulton jashtë kufirit minimal të vlerës cka përben kriter për skualifikim.*
- 2. Mungon deklarata për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.*
- 3. Operatori "Argi" sh.p.k nuk disponon fuqinë punetore të nevojshme të siguruar (në bazë të % së pjesmarrjes në bashkëpunim) për periudhën Shtator 2018- Gusht 2019.*

II.9. Në datën 04.11.2019 BOE “Argi” shpk & “HMK-Consulting” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Arsyet e refuzimit të ofertës sonë ekonomike nga ana e KVO-së së autoritetit kontraktor Bashkia Patos janë të paargumentuara dhe të pabazuara sipas DT të publikuara në sistem dhe VKM nr.914 datë 26.12.2014 i ndryshuar dhe VKM-së nr.354 datë 11.05.2016.*
Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit po ju argumentojmë metodologjinë e llogaritjes së fondit limit minimal për kualifikim për këtë objekt. Në DT-të e hedhura në sistem për tenderin e punimeve të këtij objekti kemi marrë vlerën e fondit limit për punimet e zbatimit që është në fletën nr.3 Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 450, 024,892 lekëpa tvsh.

Në DT e hedhur në sistem për tenderin e supervizionit në fletën 3 kemi Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave 4,333,333 lekë.

Me këto dy të dhëna nga ana juaj dhe mbështetur në VKM nr.354 datë 11.05.2016 nenet 34-39 kemi kryer llogaritjet si më poshtë:

Në seksionin III Vepra Inxhinierike tek neni 36 Fazat e projektimit të veprave inxhinierike në tabelën përkatëse kemi se faza e VIII Mbikqyrja është sa 20% e shërbimit total të fazave të projektimit. Pra duke u nisur nga fondi limit prej 4,333,333 lekë/20% baras me 21,666,665 lekë është fondi komplet i të gjitha fazave të projektit duke patur fondin limit të punimeve të zbatimit prej 450,024,892 lekë gjejmë koeficientin tarifor të projektimit që rezulton $21,666,665/450,024,892$ baras me 0.0481 nga tabela përkatëse në nenin 38 , tabela e tarifave për shërbimet , në lidhje me punimet e veprave inxhinierike shikojmë se fondi limit i punimeve të zbatimit është $> 450,000,000$ lekë dhe më e $< 500,000,000$ dhe koeficienti tarifor 0.0481×100 baras me 4.81% gjendet në grupin tarifor më i vogël se 4.87% dhe më i madh se 4.55 % dhe vlera minimale për kryerjen e këtij shërbimi është në grupin e III tarifor midis shifrave 4.08% dhe 3.77% me anë të interpolimit gjejmë koeficientin tarifor 4.07 % me të cilin llogarisim fondin limit minimal.

$450,024,892 \text{ lekë} \times 4.07\% = 18,316,013 \text{ lekë}$
 $18,316,013 \text{ lekë} \times 20\% = 3,663,202.6 \text{ lekë}$ pa tvsh ose
 $3,663,202.6 \text{ lekë} \times 1.2$ (20% e tvsh) $= 4,395,843 \text{ lekë}$ me tvsh.

Oferta jonë e paraqitur në këtë tender është 3,672,023 lekë pa tvsh më e madhe se fondi minimal i llogaritur që rezulton 3,663,206.6 lekë pa tvsh. Pra sic shikohet qartë ky kriter plotësohet nga ana e BOE ankimes.

- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se nga ana e BOE Argi shpk&HMK –Consulting shpk në dokumentata e paraqitura në këtë tender mungon shtojca 1/1 Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur si e tillë me këtë emërtim por nga ana jonë me të njëjtën përmbajtje dhe funksion është paraqitur me emërtimin shtojca me nr.9 Deklarata (Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit në prokurimin e objektit) . Kjo deklaratë ka brenda saj elementë të deklartaës me nr.1/1 në të cilën përcakohet se oferta është e pavarur dhe për përfaqësimin e saj nuk lejohet të prezantohet asnjë person tjetër vec përfaqësuesit të autorizuar nga BO.

Nga shqyrtimi i plotë i dokumentacionit për të 8 ofertuesit, pjesmarrës në prokurim duket qartë se oferta jonë është e pavarur nga ofertuesit e tjerë. Në bazë të LPP citoj Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentat e tendrit si dhe gabime shtypi.....devijimi nga standarti i paraqitjes së shtojcës 1.1 sipas dokumentave standarte nuk përbën kusht për skualifikim por konsiderohet si jo përcaktues për ofertën e paraqitur. Në këto kushte arsyetimi ligjor dhe vlerësimi se mungon deklarata për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 1/1 nga ana e KVO nuk përbën kusht skualifikimi.

- Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit theksojmë se në DT për këtë objekt në pikën përta i përket fuqisë punëtore keni kërkuar si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të vërtetohet me dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 6 punonjës për periudhën Shtator 2018-Gusht 2019.

Për këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatiimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Shtator 2018-Gusht 2019.

Nuk keni specifikuar si duhet të plotësohet ky kusht në rastin e bashkimit të operatorëve.

Sa i përket numrit të fuqisë punëtore që duhet të plotësojë ofertuesi sqarohet sa më poshtë:

Shoqëria Argi shpk & HMK Consulting shpk plotësojnë numrin fizik të punonjësve të kërkuar nga 6 të kërkuar plotëson në BO 18 punonjës për periudhën Shtator 2018-Shtator 2019 e vërtetuar kjo me të gjitha kërkesat e kërkuara në DT.

Sic theksohet në arsyetimin tuaj se nuk plotësohet numri i punonjësve të Argi shpk në përputhje me pjesamrrjen në shërbim 94 % arsyetimi dhe argumentimi i KVO nuk qëndron pasi: Argi shpk ka numrin fizik 3 të punonjësve në dispozicion dhe në këtë ofertë të shërbimit të kërkuar do të jetë i pranishëm me 3 punonjës nga të cilët drejtuesin teknik të shërbimit dhe inxhinierin topograf.

Bazuar në kërkesën tuaj për të qenë pjesë e ofertës edhe pjesmarrja e punonjësve gjatë kryerjes së supervizionit të objektit bazuar në pjesmarrjen të shprehur në ditë pune të secilit punonjës pjesë përbërëse e stafit të shoqërisë ose shoqërive në BO është llogaritur dhe është paraqitur analiza e pjesmarrjes së shoqërive me punonjës in e vet për përmbushjen e shërbimit cila shoqërohet me pjesën ofertuese si më poshtë:

Në supervizionin e objektit është kërkuar që shoqëritë të kenë domosdoshmëriht Inxhinierin përgjegjës i projektit me 486 ditë pune (18 muajx26 ditë pune) dhe sipas parashikimit të pjesmarrjes së punonjësve sipas profesioneve të kërkuara Ing topograf, gjeolog, elektrik, mekanik në bazë të arsyetimit të ofertuesit për domosdoshmërinë e pjesmarrjes për kryerjen e shërbimit. Bazuar na keni kërkuar BOE ka paraqitur analizën e pjesmarrjes së punonjësve e cila përcakton edhe përqindjen e pjesmarrjes së tyre në shërbim sipas tabelës pjesë e ofertës.

Ditë pune gjithsej 610 ditë pune nga të cilat shoqëria Argi shpk ka pjesmarrjen me 576 ditë pune (468 ditë pune inxhinieri hidroteknik, drejtues teknik dhe 108 ditë pune inxhinieri topograf).

Shoqëria HMK Consulting shpk ka pjesmarrjen në kryerjen e shërbimit me 34 ditë pune nga të cilat 10 ditë pune inxhinieri i ndërtimit, 8 ditë pune inxhinieri elektrik, 8 ditë pune inxhinieri gjeolog dhe 8 ditë pune inxhinieri mekanik.

Përqindja e pjesmarrjes faktike të shoqërive në realizimin e supervizionit të objektit është si më poshtë:

Shoqëria Argi shpk 576:610 ditë pune =94%

Shoqëria HMK-Consulting shpk 34:610 ditë pune =6%

VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar neni 74 i saj nuk specifikon që fuqia punëtore duhet të plotësohet sipas % të pjesamrrjes por jepet qartë për kërkesat ekonomike financiare që në rastin tonë janë vlerat e xhirove vjetore që plotësohen nga të dy operatorët, për kërkesat profesionale që në rastin tonë janë pikat e licencës

*profesionale dhe ISOT dhe plotësohen nga të dy operatorët, për kërkesat teknike që në rastin tonë janë shërbimet e ngjashme dhe plotësohen nga të dy operatorët .
Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e BOE Argi shpk & HMK Consulting shpk.*

II.10. Në datën 08.11.2019 me shkresën nr.2991/2 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes "Argi" shpk & "HMK Consulting" shpk ku ka vendosur mospranim e ankesës.

II.11. Në datën 15.11.2019 pala ankimese BOE "Argi shpk & "HMK Consulting" shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.3199/1 prot datë 26.11.2019 protokolluar me tonën me nr.1753/2 prot datë 02.12.2019 me objekt "Dërgohet informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "GB Civil Engineering" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "*Ju s'kualifikoheni pasi nuk plotësoni kriterin e vecantë të kualifikimit, kontratë shërbimi e ngjashme, pasi ne dy prej kontratave të mbikqyrjes të lidhura mungojnë formularët e vleresimit*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën "Modifikim mbi dokumentat e tenderit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

ISHTE

2.3 Për kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme shërbimesh në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit dhe konkretisht 1,733,333(një milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Per të vertetuar përvorjen e mëparshme detyrimisht të paraqiten dokumentat si më poshtë:

a.Kur kontratat janë të realizuara me institucione publike ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontratën/Kontratata
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/Çertifikatat e marrjes ne dorezim.
6. Faturat tatimore perkatese per çdo situacion te miratuara nga investitori.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- *Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit.*
- *Prokura e posaçme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi.*

Ne rast se kontrata e paraqitur eshte realizuar si Nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon :

- *Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor*
- *Miratimi zyrtar si nenkontraktor nga ana e autoritetit kontraktor*

2.3.1/b *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë*

dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontrate/Kontratata.
3. Leja e ndertimit
4. Situacionin përfundimtar;
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;

Fatura tatimore per cdo situacion punimesh te miratuara nga investitori

BEHET:

A.K ka vendosur te heqe disponimin e lejes se ndertimit, ne cilesine e dokumentacionit vertetues te punes se ngjashme, meqenese eshte kerkuar akt- kolaudimi, si nje dokument që vërteton realizimin e punës në përputhje me lejen e ndërtimit.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrata te ngjashme sherbimesh ne vlere totale prej jo me pak se 40 % e fondit limit dhe konkretisht 1,733,333(nje milion e shtateqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) leke te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave.

Per te vertetuar pervojen e meparshme detyrimisht te paraqiten dokumentat si me poshte:

a.Kur kontratat jane te realizuara me institucione publike ofertuesi duhet te paraqese:

7. Formularin e vleresimit

8. *Kontratën/Kontratata*
9. *Situacionin përfundimtar;*
10. *Aktin e kolaudimit;*
11. *Çertifikaten/Çertifikatat e marrjes ne dorezim.*
12. *Faturat tatimore perkatese per çdo situacion te miratuara nga investitori.*

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- *Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit.*
- *Prokura e posaçme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi.*

Ne rast se kontrata e paraqitur eshte realizuar si Nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon :

- *Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor*
- *Miratimi zyrtar si nenkontraktor nga ana e autoritetit kontraktor*

2.3.1/b *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

7. *Formularin e vleresimit*
8. *Kontrate/Kontratata.*
9. *Situacionin përfundimtar;*
10. *Akt kolaudimi objekti;*
11. *Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;*
12. *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh te miratuara nga investitori*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimes “GB Civil Engineering” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.2499 prot dt 12.09.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrje objekti për ndërtim linje ujësjellësi Ø 500 për lidhjen e depos së re Arapaj me rrjetin shpërndarës Plazh, Bashkia Durrës. Vlera e kontratës është **594,104** lekë pa tvsh.*
- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Formular Vlerësimi nr.1961 prot datë 20.09.2018*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion Përfundimtar*
- *Akt Marrje në Dorëzim*

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me nr.1500/1 prot datë 06.05.2017 me AK Ujësjellës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrje e objektit Ndërtim rrjeti i ri në lagjen Gramshi, Njësia Adm, Rashbull, Bashkia Durrës. Vlera e Kontratës është **296,230** lekë pa tvsh.*

- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion përfundimtar*
- *Akt Marrje në dorëzim të objektit*

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1948/1 prot datë 17.07.2017 me AK Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha, me objekt Mbikqyrje për prokurimin me objekt Përmirësimi i furnizimit me ujë lagjia 14, Bashkia Durrës. Vlera e Kontratës është **111,864** lekë pa tvsh.*
- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion përfundimtar*
- *Akt Marrje në dorëzim të objektit*

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1660/1 prot datë 22.06.2017 me AK Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha , me objekt Mbikqyrje e objektit Rehabilitim i linjave kryesore të ujësjetllësit lagjia 16, rruga H.Kertusha dhe A. Celkupa Bashkia Durrës. Vlera e kontratës është **231,385** lekë pa tvsh.*
- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Vërtetim Realizimi Nr.3006/1 prot datë 07.11.2017*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion përfundimtar*
- *Akt Marrje në dorëzim të objektit*

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me Nr.1465 prot datë 26.06.2018 me AK Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha me objekt Mbikqyrja e punimeve për zbatimin e objektit Rehabilitimi i linjave të ujësjetllësit në lagjen 15, ish punishtja e makaronave, rruga Dardania, Gjeneral Telin, vëllezrit Frashëri, Pjetër Budi, Bashkia Durrës . Vlera e kontratës është **293,257** lekë pa tvsh.*
- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Formular Vlerësimi Nr.2809/1 datë 05.10.2018*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion Përfundimtar*
- *Akt Marrje në Dorëzim të objektit*

- *Kontratë për mbikqyrje punimesh me nr.2328 prot datë 19.11.2018 me AK Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha, me objekt Mbikëyrje për prokurimin me objekt Rehabilitimi i*

*rrjetit të ujësjellësit në zonat e lagjeve nr.1, nr.4, nr.5, nr.8, nr.18 Bashkia Durrës.
Vlera e kontratës është 436,338.62 lekë pa tvsh.*

- *Kopje të faturës së shërbimit*
- *Formular Vlerësimi*
- *Akt Kolaudimi*
- *Situacion Përfundimtar*
- *Akt Marrje në Dorëzim të objektit*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 përcaktohet se: *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

- *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.1.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata të ngjashme shërbimesh në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit dhe konkretisht 1,733,333 leke të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për të vertetuar përvojën e mëparshme detyrimisht të paraqiten dokumentat si më poshtë:

a. Kur kontratat janë të realizuara me institucione publike ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin e vlerësimit; Kontratën/Kontratën; Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Çertifikatën/Çertifikatat e marrjes në dorezim; Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion të miratuar nga investitori.

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Formularin e vlerësimit; Kontrate/Kontratën.; Situacionin përfundimtar; Akt kolaudimi objekti; Çertifikatën e marrjes në dorezim të objektit; Fatura tatimore për çdo situacion punimesh të miratuar nga investitori.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "GB Civil Engineering" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri janë dorëzuar një sërë kontratash të lidhura me ent publik për të cilat ankimuesi ka paraqitur dokumentacionin shoqëruar të kërkuar në kriterin e kualifikimit të tilla si Formularin e vlerësimit; Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Çertifikatën/Çertifikatat e marrjes në dorezim; Faturat Tatimore Shitje. KPP vëren se për kontratat me nr.1660/1 prot, nr.1948/1 prot, nr.1500/1 prot operatori ekonomik ka dorëzuar Vërtetim Realizimi nr. 3006/1 prot datë 07.11.2017 lëshuar nga enti publik Ujësjellës Kanalime Durrës sha.

Sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në thellësi dhe në mënyrë të arsyeshme eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka gjykuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi në mënyrë sipërfaqësore duke pretenduar se mungon Formulari i Vlerësimit. Për këtë autoriteti duket se i është refuzuar formati i standart të formularit të vlerësimit pjesë e dokumentave të tenderit por ndërkohë ka anashkaluar përcaktimet ligjore dhe nëligjore të cilat parashikojnë në mënyrë të shprehur dhe eksplicite se në rast të paraqitjes së kontratave të lidhura me ente publike si dëshmi të përvojës së mëparshme do të pranohen vërtetime të lëshuara nga këto ente. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit rezulton se është paraqitur në përputhje me ligjin vërtetim realizimi lëshuar nga enti publik duke përmbushur kështu në mënyrë të plotë kriterin e kualifikimit pasi në vetvete formulari i vlerësimit dhe vërtetim realizimi janë dokumenta ekuivalente të njëra tjetrës pasi në thellësi dëshmojnë faktin se kontrata është realizuar me sukses nga ana e kontraktorit, në rastin konkret kjo është përmbushur tërësisht nga operatori ekonomik ankimues "GB Civil Engineering" shpk.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Argi” shpk& “HMK-Consulting” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Mungon deklarata per paraqitje oferte te pavarur sipas Shtojces 1/1”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Operatorët ekonomikë ankimues “Argi” sh.p.k dhe “HMK Consulting” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të Marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik me Nr.7670 Rep dhe Nr. 5327 Kol datë 03.10.2019. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “Supervizim në objektin “Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës).

Në nenin 3 “Pjesmarrja” të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se Shoqëria Argi shpk nëpërmjet stafit të saj do të realizojë mbikyrjen e punimeve të objektit në masën prej 94 % me specialistët e licesuar në shoqëri sipas përkatësisë do të ketë drjetuesin teknik të mbikqyrjes në kohë të plotë me inxhinierin Hidroteknik dhe punimet topografike me inxhinierin Gjeodet sipas ditëve të punës dhe do të mbulojë të gjitha shpenzimet për përmbshjen e shërbimit sipas detajimit të kostove në ofertën e bashkimit të shoqërive dhe do të mbulojë të gjitha shpenzimet për këtë objekt.

Shoqëria HMK Consulting shpk nëpërmjet stafit të saj do të realizojë mbikqyrjen e punimeve të objektit në masën 6 % me specialistët e licesuar në shoqëri sipas përkatësisë do të ketë me kohë të pjesshme inxhinierin e ndërtimit, inxhinierin mekanik dhe inxhinierin gjeolog sipas ditëve të punës të shprehura në detajimin ekostove në ofertën e bashkimit të shoqërive.

III.2.2. Në shtojcën 1/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:

(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;

- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

III.2.3. Në shtojcën 7 Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;
- ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, **te leshuar jo me heret se 30 dite nga data e hapjes se ofertes.**

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.2.5. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk ka paraqitur asnjë shtojcë 1/1 me emërtim “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” sikundër kërkohet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar edhe parashtimeve në ankesë të BOE ankimues rezulton se ai pranon mosparaqitjen e kësaj shtojce me argumentat si vijon: *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se nga ana e BOE Argi shpk&HMK – Consulting shpk në dokumentata e paraqitura në këtë tender mungon shtojca 1/1 Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur si e tillë me këtë emërtim por nga ana jonë me të njëjtën përmbajtje dhe funksion është paraqitur me emërtimin shtojca me nr.9 Deklarata (Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit në prokurimin e objektit) . Kjo deklaratë ka brenda saj elementë të deklartaës me nr.1/1 në të cilën përcakohet se oferta është e pavarur dhe për përfaqësimin e saj nuk lejohet të prezantohet asnjë person tjetër vec përfaqësuesit të autorizuar nga BO. Nga shqyrtimi i plotë i dokumentacionit për të 8 ofertuesit, pjesmarrës në prokurim duket qartë se oferta jonë është e pavarur nga ofertuesit e tjerë. Në bazë të LPP citoj Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe gabime shtypi.....devijimi nga standarti i paraqitjes së shtojcës 1.1 sipas dokumentave standarte nuk përbën kusht për skualifikim por konsiderohet si jo përcaktues për ofertën e paraqitur. Në këto kushte arsyetimi ligjor dhe vlerësimi se mungon deklarata për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 1/1 nga ana e KVO nuk përbën kusht skualifikimi.*

III.2.7. Referuar parashtimeve sa më sipër KPP vëren se shtojca 9 e paraqitur nga BOE ankimues me emërtimin “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit në prokurimin e objektit”, me anë të së cilës BOE ankimues pretendon se ka zëvendësuar

shtojcën 1/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përmbajtje si vijon:

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 07.10.2019 nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Patos, me objekt Mbikqyrje e punimeve ne objektin” Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)”, me fond limit 4.333.333 (katër milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari Llambi Tarka, në cilësinë e administratorit të Konsulentit “ARGI” sh.p.k, nën përgjegjësinë time personale, Deklaroj se:

1. Paraqitja e të gjithë dokumentacionit te nevojshëm, në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 07.10.2019 nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Patos, me objekt Mbikqyrje e punimeve ne objektin” Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)”, me fond limit 4.333.333 (katër milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH, te shoqerive Jv./ “ARGI” sh.p.k. & “HMK Consulting” sh.p.k,do te behet nga Llambi Tarka.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit, është i pamiraturar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, me asnjë nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës 07.10.2019

III.2.8. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se ka zëvendësuar shtojcën 1/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi me shtojcën 9 të sipërcituar nuk qëndron për arsye se kjo deklaratë jo vetëm ndryshon nga pikëpamja e formës por edhe nga pikpamja e përmbajtjes me shtojcën 1/1 pjesë e dokumentave të tenderit. Devijimi nga plotësimi i standartit të shtojcës në rastin konkret nuk mund të konsiderohet devijim i vogël sikundër pretendon BOE ankimues pasi fakti është që shtojca 1/1 në rastin konkret konsiderohet se nuk është paraqitur në këtë procedurë prokurimi. BOE ankimues me vullnetin e tyre të lirë kanë anashkaluar të plotësojnë shtojcën 1/1 sipas formatit standart të dokumentave të tenderit dhe në vend të saj kanë paraqitur një deklartatë tjetër e cila jo vetëm në aspektin formal por edhe atë të përmbajtjes ndryshon nga shtojca 1/1 të dokumentave të tenderit.

KPP gjykon se deklarata e sipërcituar e dorëzuar nga BOE ankimues nuk plotëson qëllimin për të cilin është vendosur shtojca 1/1 dhe është bërë pjesë e dokumentave të procedurës së prokurimit. Akoma më tej KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, apo plotësimi i saj në formë dhe përmbajtje të gabuar që nuk përmbush qëllimin për të cilin është kërkuar, përbën shkak për skualifikim në kuptim

të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përputhet ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Referuar arsytimit sa më sipër, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues “Argi” shpk & “HMK Consulting” shpk në rastin konkret nuk është i saktë dhe nuk është në përputhje me përcaktimet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë ankimues “Argi” shpk & “HMK Consulting” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga BOE ankimues “Argi” shpk & “HMK Consulting” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe BOE ankimues nuk përmbush kriteret kualifikuese dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-37051-09-24-2019 me objekt “*Supervizim në objektin “Rikonstrukcioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)*”, me fond limit 4.333.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.10.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Argi” shpk & “HMK-Consulting” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1752 Protokolli; Datë 14.11.2019

Nr. 1753 Protokolli; Datë 15.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha